

KOMISIONI I DISIPLINËS VENDIM Nr. 5

Nr. 106 Prot.

16 Dhjetor 2025

Më datë **16 Dhjetor 2025**, u mbledh **Komisioni i Disiplinës** i Federatës Shqiptare të Basketbollit, nën drejtimin e kryetarit, **z. Klevis Kaso**, me praninë e anëtarëve, **z. Ersi Oruci** dhe **z. Marsel Aliaj**, për shqyrtimin e problematikës të ndodhur në ndeshjen e Kampionatit Kombëtar Meshkuj, Kamza Basket vs KS Tirana, ndeshja e vlefshme për javën e IX, datë 13 Dhjetor 2025, në sallën e sportit "Kamza".

Pas shqyrtimit të materialeve përkatëse, përfshirë relacionin e vëzhguesit të ndeshjes, si dhe në bazë të **Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, **Komisioni i Disiplinës** vendosi:

1. **Përrjashtim 6 muaj nga të gjitha aktivitetet e FSHB-së dhe sanksion financiar 100'000 lekë, për z. Xhersido Hajdari**, bazuar në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit, neni 14.12:

"Sulmi fizik ndaj kundërshtarëve (lojtarë, trajnerë, etj.), spektatorëve, pjesëtarëve të ekipit të tij, zyrtarëve të ndeshjes (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj.) apo pjesëmarrësve të tjerë në ndeshje, para, gjatë ose pas ndeshjes."

E Drejta për Ankimim

Sipas **nenit 11.8 të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda **72 orëve** nga marrja e vendimit. Ankimi duhet të dorëzohet pranë **Komisionit të Apelit të FSHB-së** dhe të shoqërohet me vërtetimin e pagesës prej **10'000 lekësh** në llogarinë e FSHB-së.

Një kopje e kërkesës së ankimimit i dërgohet palëve të përfshira. **Komisioni i Apelit** shqyrton çdo vendim të **Komisionit të Disiplinës** që kontestohet nga palët e interesuara.

Vendimet e **Komisionit të Apelit** mund të ankimohen pranë **Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS)**.



Klevis Kaso
Kryetar



Ersi Oruci
Anëtar



Marsel Aliaj
Anëtar